



Prof. Assoc. Dr. Lila Shundi

Profesor – Përgjegjëse e
Departamentit të Formimit të
Përgjithshëm dhe Zhvillimit
Profesional

KONTAKTE

✉ dep.mjekesi-prof@umb.edu.al



Prof. Assoc. Dr. Lila Shundi

Profesor – Përgjegjëse e
Departamentit të Formimit të
Përgjithshëm dhe Zhvillimit
Profesional

BIOGRAFIA

Prof. Assoc. Lila Shundi është diplomuar në vitin 1989 në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës. Në periudhën 1994–1999 ka zhvilluar aktivitetin e saj kërkimor pranë Laboratorit të Epidemiologjisë Molekulare në Institutin Cantacuzino, Bukuresht, Rumani, në kuadër të studimeve doktorale dhe postdoktorale.

Në vitin 1999 ka marrë gradën “Doktor i Shkencave në Gjenetikë” pranë Departamentit të Gjenetikës, Fakulteti i Biologjisë, Universiteti i Bukureshtit, ndërsa në vitin 2016 ka mbrojtur titullin shkencor “Profesor i Asociuar”.

Gjatë periudhës 2000–2002 ka punuar si kërkuese shkencore në Departamentin e Mikrobiologjisë pranë Institutit të Kërkimeve Biologjike, Akademia e Shkencave, Tiranë. Që prej vitit 2002 është kërkuese shkencore në Institutin e Shëndetit Publik, ku ushtron funksionin e Përgjegjëse së Njesisë Bazë të Laboratorëve të Referencës Kombëtare.

Ka projektuar dhe vënë në funksion disa laboratorë në fushën e biologjisë molekulare në Shqipëri, si:

Laboratori i Mikrobiologjisë dhe Diagnostikës Molekulare në Institutin e Shëndetit Publik

Laboratori i Diagnostikës Molekulare të Sëmundjeve Gjenetike dhe Diagnozës së Paralindjes pranë Maternitetit “Mbretëresha Geraldinë”, Tiranë

Laboratori Qendror për Depistimin e Kancerit të Qafës së Mitrës, etj.

Ajo ka sjellë për herë të parë në Shqipëri:

Diagnozën molekulare të sëmundjeve infektive për agjentë patogjenë si: Streptokoku i grupit A, hepatitet virale, HIV, HPV, klamidia, neiseria

Diagnozën paralindore të sëmundjeve gjenetike

Teknikat imunohistokimike për menaxhimin e pacienteve me kancer të gjirit

Prof. Assoc. Shundi drejton depistimin laboratorik në kuadër të Programeve Kombëtare për Kancerin. Në fushën e mësimdhënies, që nga viti 2008 është angazhuar në disa universitete publike dhe private.